

Siguria në Prishtinë



RAPORTI 2016

**Prishtina
po bëhet**



Pastrimi i deponive me mbeturina inerte

Në kuadër të projekteve për lirimin e hapësirave publike dhe funksionalizimin e tyre, si dhe ngritjen e sigurisë dhe mbrojtjen e shëndetit publik, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Inspeksionit, kanë pastruar mbi 232 deponi me mbeturina inerte. Deponitë me mbeturina inerte janë edhe vende që joshin qentë endacakë për ushqim dhe pastaj kjo përcjellet me rrezik nga grupe të shumta të qenëve endacakë ndaj qytetarëve.

Pas pastrimit, shumë hapësira janë shëndrruar në parqe dhe hapësira të gjelbra, por, fatkeqësisht, shumë nga këto deponi janë kthyer prapë në gjendje të keqe për shkak të hedhjes së mbeturinave nga persona të papërgjegjshëm.

Deponitë e larguara në këto lokacione:

- Grashticë – Mramur”, janë larguar 5 (pesë) deponi me mbetje të ndryshme ndërtimore dhe të amvisërisë;
- Barilevë, janë larguar dhe pastruar 3 (tri) deponi;
- Trudë, janë larguar mbeturina në 2 (dy) deponi;
- Prugovc, janë larguar, pastruar dhe rehabilituar 2 (dy) deponi;
- Bërnice, janë larguar mbeturina në 2 (dy) deponi;
- Zllatar, janë larguar mbeturina në 4 (katër) deponi;
- Lebanë, janë larguar mbeturina dhe rehabilituar 2 (dy) deponi;
- Hajvali, janë larguar mbeturina në 7 (shtatë) deponi;
- Bardhosh, janë larguar mbeturina në 3 (tri) deponi, njëra nga këto është rehabilituar dhe është kthyer në hapësirë gjelbëruese, afër Bashkësisë Lokale;
- Llukar, janë larguar mbeturina në 2 (dy) deponi;
- Vranidoll, janë larguar mbeturina në 2 (dy) deponi;
- Grashticë-Stallovë, janë larguar mbeturina në 5 (pesë) deponi;
- Ruga “Xheladin Hana”, janë larguar mbeturina në 3 (tri) deponi;
- Ruga “Rahim Beqiri”, janë larguar mbeturinat në 1 (një) deponi;
- Ruga “Afrim Zhitia”, janë larguar mbeturina në 1 (një) deponi;
- Lagjja “Arbëria”, te varrezat, janë larguar mbeturina në 2 (dy) deponi;
- Lagjja “Arbëria”, rr.“Qemajl Stafa” dhe lagjja “Shkabaj”, janë larguar mbeturina në 5 (pesë) deponi;



- Lagjja "Arbëria", rr."Qemajl Stafa" dhe lagjja "Shkabaj", janë larguar mbeturina në 5 (pesë) deponi;
- Kodra e Trimave, te shkolla "Asim Vokshi", janë larguar mbeturina në 2 (dy) deponi;
- Bulevardi "Bill Klinton", te ish "Ramiz Sadiku", janë larguar mbeturina në 1 (një) deponi;
- Rruga "Bajram Bahtiri" dhe Fusha e Pajtimt, janë larguar mbeturina në 2 (dy) deponi;
- Rruga "UÇK" te biblioteka "Hivzi Sylejmani 1";
- Lagjja "Dardania" te "Tuneli", janë larguar mbeturina në 2 (dy) deponi;
- Rruga "Eqrem Çabej" janë larguar mbeturina në 1 (nje) deponi;
- Rruga "Fehmi Lladrovci", janë larguar mbeturina në 1 (nje) deponi;
- Rruga për Gërmi, në të majtë, para "Laures" janë larguar mbeturina në 2 (dy) deponi;
- Rruga "Dëshmorët e Marecit", janë larguar mbeturina në 2 (dy) deponi;
- Rruga "Haxhi Zeka", janë larguar mbeturina në 2 (dy) deponi;
- Rruga "Isa Kastrati", janë larguar mbeturina në 3 (tre) deponi;
- Rruga "Rifat Burgjeviq", janë larguar mbeturina në 2 (dy) deponi;
- Rruga "Enver Maloku", janë larguar mbeturina në 1 (një) deponi;
- Rruga "Malush Kosova", janë larguar mbeturina në 2 (dy) deponi;
- Te shkolla fillore "Meto Bajraktari", janë larguar mbeturina në 1 (një) deponi;
- Nga hapësirat e parkingjeve në Dardani, janë larguar mbeturina në 4 (katër) deponi;
- Rruga "Hyzri Talla", janë larguar mbeturina në 2 (dy) deponi;
- Rruga "Zija Shemsiu", janë larguar mbeturina në 2 (dy) deponi;
- Rruga "28 Nëntori", janë larguar mbeturina në 2 (dy) deponi;



- Rruga "Iliaz Kodra" në Dardani, janë larguar mbeturina në 2 (dy) deponi;
- Rruga "Mulla Idriz Gjilani", janë larguar mbeturina në 1 (një) deponi;
- Rruga "Kosta Novaković", janë larguar mbeturina në 1 (një) deponi;
- Rruga "Sali Nivica", janë larguar mbeturina në 2 (dy) deponi;
- Në lagjen "Taukbahçe", të rruga "1 Tetori", janë larguar mbeturina në 1 (një) deponi;
- Në lagjen "Tophane" të rruga "Vushtrria", janë larguar mbeturina në 1 (një) deponi;
- Në lagjen "Kodra e Trimave", prapa objektit të Zjarrëfiksive, janë larguar mbeturina në 1 (një) deponi;
- Rruga "Bedri Shala", janë larguar mbeturina në 1 (një) deponi;
- Rruga "Qamil Bala", janë larguar mbeturina në 1 (një) deponi;
- Rruga "Garibaldi", janë larguar mbeturina në 1 (një) deponi;
- Rruga "Behar Begolli" (ishrruga "Shkupi"), janë larguar mbeturinat dhe kjo hapësirë është kthyer në gjelbrim një lokacion;
- Lagjja "Kalabria", rruga mbi kolektor, afër Stacionit të Autobusëve, janë larguar mbeturina në 3 (tri) deponi;
- Rruga "Tahir Zajmi", janë larguar mbeturina në 1 (një) deponi;
- Zona industriale, afër bazës së Karabinierëve, 1 (një) deponi;
- Lagjja "Përroi i Njelmët" janë larguar mbeturina në 4 (katër) deponi;
- Rruga "Enver Maloku" dhe Kolektori afër rrethit, janë larguar mbeturina në 2 (dy) deponi;
- Lagjja "Mati", afër QKMF-së, janë larguar mbeturina në 1 (një) deponi;

Zgjerimi, rikonstuktimi dhe mirëmbajtja e ndriçimit publik

Ndriçimi publik është i organizuar në dy projekte: mirëmbajtje të rregullt dhe zgjerimi i rrjetit në ato pjesë të qytetit apo lagje rurale ku ende nuk ka ndriçim.

Me këtë kemi arritur që deri me tani të kemi në sistem të rregullt të ndriçimi 600 rrugë, hapësira publike, parkingje, parqe, plato dhe nënkalime. Për mirëmbajtjen e ndriçimit publik i kemi të angazhuara 4 (katër) kompani, duke përfshirë këtu rrugët e qytetit dhe ato rurale.

Po ashtu, është bërë ndriçimi i oborreve të shkollave, çerdheve publike si dhe QKMF-ve.

Kjo gjendje e zgjerimit të sistemit të ndriçimit publik ka ndikuar shumë në përmirësimin e jetës së qytetarëve, në veçanti në aspektin e sigurisë së përgjithshme dhe lëvizjen e lirë edhe në orët e vona të natës.



Zgjerimi i ndriçimit publik në këto lokacione:

Fshati Bardhosh – janë ndriçuar 830m rrugë të lagjeve.

Fshati Bërrnicë e Poshtme – janë ndriçuar 2850m rrugë.

Fshati "Bërrnicë e Epërme"- janë ndriçuar 1305m rrugë.

Fshati Grashticë – janë ndriçuar 630m rrugë.

Fshati Slivovë – janë ndriçuar 30m rrugë.

Lagjja "Hajvalia" – janë ndriçuar 20m rrugë.

Lagjja "Kodra e Trimave" – janë ndriçuar 30m rrugë.

Rruga "Ekrem Rexha"- në gjatësi prej 400m rrugë.

Zgjerimi i ndriçimit publik në fshatra dhe qytet – 12,700m gjatësi

Ndriçimi publik në: fshatin Rimanishtë; fshatin Sharban; fshatin Besi; rr. "Shala e Bajgorës"; rr. "Beteja e Koshares"; rr. "Tabet e Llapashticës"; rr. "Petro Marko"; rr. "Tomori"; rr. "Preveza"; rr. "Dr. Shpëtim Robaj" (prapa shkollës); fshati Grashticë; lagjja "Kelmendi" rr. "Dëshmorët e Marecit"; rr. "Agim Çela"; rr. "Papa Gjon Pali"; lagjja "Matiqan" deri tek vendi i quajtur "Çezmja" dhe Zllatar; fashti Dabishec - lagjja "Hasimi"; rr. "Xhavit Ahmeti" – rrugët lidhëse; Veternik- rr. "Agim Hajrizi" – në gjatësi prej 686m.

Zgjerimi i ndriçimit publik në Qendrën e Mjekësisë Familjare "Mati 1", te shkolla "Pavarësia" dhe rruga lidhëse – në gjatësi prej 620 m.

Zgjerimi i ndriçimit publik në parkingun te "Santea" – në gjatësi prej 225 m.

Zgjerimi i ndriçimit publik në parkingun tek "Termokosi" – në gjatësi prej 560 m.

Zgjerimi i ndriçimit publik në parkingun dhe parkun e vjetër në lagjen "Dardania" – në gjatësi prej 990 m.

Zgjerimi i ndriçimit publik në parkingjet – në lagjen "Ulpiania" - në gjatësi prej 1260 m.

Zgjerimi i ndriçimit publik në shkollat e qytetit të Prishtinës – në gjatësi prej 1500 m, si në vijim: lagjja "Dardania", rruga "Faik Konica", rruga "Naim Frashëri", rruga "Nexhmi Mustafa" dhe rruga "Luan Haradinaj", në gjatësi prej - 1600 m.

12.5 km gjatësi, ku janë vendosur 593 copë trupa ndriçues, në 59 rrugë dhe lagje të ndryshme në qytet dhe pjesën rurale, të cilat janë cekur në vijim:

rr. "Perandori Justinian"; rr. "Radovan Zogoviq" (ish "Lorenc Antoni"); rr. "Sejdi Kryeziu"; rr. "Nazmi Mustafa" (ish rr."Mbreti Zogu I"); rr. "Mujo Ulqinaku"; rr. "Pashko Vasa"; rr. "Harmonia" (ish-rr."Jonuz Zejnullahu"); rr. "Demokracia"; rr. "Aziz Zhilivoda"; rr. "Perandori Dioklecian"; rr. "Gani Demolli"; rr. "Çajkovski"; rr. "Janina"; rr. "Skënder Luarasi" (ish-"Kadri Zeka"); rr. "Shefki Desivojca"; rr. "Hisen Arifi"; rr. "Ibrahim Fehmiu"; rr. "Nesibe Zhuri"; rr. "Naim Sylja"; rr. "Riza Dani"; rr. "Kuvendi i Arbërit"; rr. "Gryka e Llapushnikut"; rr. "Rifat Kukaj"; rr. "Ludvik Van Betoven"; rr."Vëllezërit Fazliu", pa emërtim ende (te "Unioni"); rr. lidhëse me rr. "Vëllezërit Fazliu" pa emërtim ende, përballë me Njësinë e Zjarrfikësve; rr. "Kapiten Hysni Rudi"; rr. "Besnik Restelica"; rr. "Shemsi Haziri"; rrugët lidhëse me rr."Vëllezërit Fazliu" tek barnatorja "Adonisi"; rr. "Elena Gjika"; rr. "Bedri Gjini"; rr. "Zenel Bajraktari"; rr. "Fitush Kukaj"; rr. "Aleksandër Mojsiu"; rr. "Aleksandër Xhuvani"; rr. "Isa Havolli"; rr. "Thethi"; rr. "Naum Veqilhargji"; rr. "Dëshmorët e Prapashticës"; rr. "Veternik"; rr. "Kamer Loshi"; rr. "Lagjja e Berishëve"; rr. "Haxhi Zeka –Kolovicë"; rr. "Ismet Asllani"; rr. "Sabri Preveza"; rr. "Bedri Pejani; rr. "Malush Kosova"; rr. fshati Llukar; lagjja "Ulpiana"; lagjja "Veterniku"; lagjja "Kodra e Diellit", te banesat e bardha; rr. "Ndue Përlleshi";

Riparimi dhe rregullimi i ashensorëve në qytetin e Prishtinës

Deri më tani kanë përfunduar 4 (katër) ashensorë, kurse në realizim, sipas kontratës, janë edhe 6 (gjashtë) të tjerë, që do të thotë se me këtë kontratë realizohen 10 (dhjetë) ashensorë. Ndërsa në lagjen "Kodra e Diellit", te banesat e bardha, një ashensor është ndërtuar i ri. Intervenimet përmes këtij projekti bëhen në bazë të kërkesave, duke u dhënë përparësi personave me nevoja të veçanta, të moshuarve si dhe nënave me fëmijë të vegjël.


Intervenimet janë bërë në këto lokacione:

1. Hyrja 15 në lagjen "Dardania", ashensori është përfunduar.
2. Rruga "Agim Ramadani", në lagjen "Aktash III", ashensori është përfunduar.
3. Lagjja "Kodra e Diellit" (te banesat e bardha), blloku 10, hyrja 2, ashensori është përfunduar.
4. Lagjja "Dardania", blloku B 4/4 F-5, ashensori është përfunduar.
5. Rruga "Hajdar Dushi" - blloku B, ka filluar të realizohen punimet.

10 ASHENSORË



Ndërtimi i ashensorit të ri: "Kodra e Diellite", blloku 10, hyrja 2



Pamje e kabinës së ashensorit të ri, i realizuar me participim të banorëve

Siguria në komunikacion

Komuna e Prishtinës, në bashkëpunim me DEMOS-in zviceran, ka realizuar projektin për ndriçimin e vendkalimeve të këmbësorëve, duke vendosur panela ndriçues. Përmes këtij projekti është ndërmarrë një masë shtesë për të parandaluar aksidentet, në atë mënyrë që pika ndriçuese tërheq vëmendjen e drejtuesve të automjeteve dhe thekson vendkalimin. Deri më tani panelet ndriçuese janë vendosur në rrugët: "1 Tetori", "Agim Ramadani", "Mon Balaj", "Bill Clinton", "Dëshmorët e Kombi", "Fehmi Lladrovci", "Eqrem Çabej", "Xheladin Rekaliu", "Enver Maloku", "Muharrem Fejza", "Vëllezërit Fazliu" dhe "Bajram Bahtiri".





Vendosja e njës së semaforëve në udhëkryqin e rrugëve “Ilir Konushevc”, “Vëllezërit Fazliu”, “Bajram Bahtiri”, dhe “Zagrebi”. Me rregullimin e udhëkryqit dhe lëshimin në funksion, është rregulluar qarkullimi i mjeteve motorike dhe kalimi i këmbësoreve, porse dhe është rritur siguria për të gjithë pjesëmarrësit në komunikacion rrugor.



14 vendkalime të ngritura për këmbësorë në afërsi të institucioneve edukativo-arsimore.

“Gungat artificiale” (ngritjet e vendkalimeve për këmbësorë) në afërsi të institucioneve shkollore, i ka kryer kompania “Eing Com”, përmes kontratës në vlerë prej 28,711.00€.

Projekti “Gungat artificiale” (ngritjet e vendkalimeve për këmbësorë) është realizuar në disa pika në afërsi të institucioneve shkollore dhe në disa vendkalime të këmbësoreve, ku frekuentimi është më i theksuar, me qëllim të rritjes së sigurisë.

Po ashtu, në fushën e sigurisë në komunikacion ka ndikuar shumë pozitivisht, për faktin se kjo ndikon drejtpërdrejt në zvogëlimin e shpejtësisë dhe rritjen e sigurisë në këto pika. Por, kjo do të ndikojë edhe në rritjen e vetëdijës për drejtuesit e automjeteve, se duhen respektuar dispozitat ligjore dhe rregullat e komunikacioni edhe në ato vendkalime të këmbësorëve ku nuk ka ngritje të tilla, për shkak se lehtë mund të rrezikohet jeta dhe shëndeti i këmbësorëve.



Vendosja e shtyllave anti-parking dhe e rrethojave për mbrojtjen e

gjelbërimit, është bërë përgjithësisht në rrugët kryesore dhe ato dytësore, ku është vlerësuar se është e nevojshme mbrojtja e gjelbërimit apo lirimi i trotuareve.

6659 shtylla antipark janë vendosur në rrugët: "Eqrem Çabej", "Xhorxh Bush", "Qamil Hoxha", "Sylejman Vokshi", "Luan Haradinaj", "Fehmi Agani", "Rexhep Luci", "Fazli Grajqevci", "Ilaz Kodra", "Ilir Konushevc", "Bill Clinton", "UÇK", "Perandori Justinan", "Dëshmorët e Kombit", "Fehmi Lladrovci", "Dr. Shpëtim Robaj", "Enver Maloku", "Muharrem Fejza", "Agim Ramadani", "Ardian Krasniqi", "Armend Daci", "28 Nëntori", "Enver Maloku", "Arkitekt Karl Gega", "Hyzyri Talla", "Tirana", "Ibrahim Lutfiu", "Nazim Gafurri", "Xehaldin Rakaliu", "Bajram Bahtiri", "Ismail Dumoshi", "Dritan Hoxha", "28 Nëntori", "Rifat Burgjeviq", "Mic Sokoli", si dhe në hapësirat rreth Stacionit të autobusëve, te rrethi dhe te pllatoja e Kurrizit.

1300 rrethoja për mbrojtjen e gjelbërimit, janë vendosur në rrugët: "Ilaz Kodra", "Enver Maloku", "Ismail Dumoshi", "Xhemajl Mustafa", "28 Nëntori", "Fazli Grajqevci", "Ulpiana", "Xheladin Rakaliu", "Rifat Burgjeviq".



Shtyllat antipark elektronike, janë vendosur në sheshet kryesore, për ta ndaluar qarkullimin e mjeteve motorike brenda shesheve. Me vendosjen e tyre është rregulluar hyrja dhe furnizimi me pajisje dhe mallrave të ndryshme për aktivitetet e organizuara në shesh.




Pengesat rrugore janë vendosur në këto rrugë:

"Ismajl Domoshi",
 "Mic Sokoli",
 "Bajram Bahtiri",
 "Ilaz Kodra",
 "Zija Shemsiu",
 "Ardian Krasniqi",
 "Xhemajl Mustafa",
 "1 Tetori",
 "Drenica",
 "Xhavit Ahmeti",
 "Vushtrria",
 "Shpëtim Robaj",
 "Muharrem Fejza",
 "Trepça",



Po ashtu, me qëllim të rritjes së sigurisë në komunikacionin rrugor, janë realizuar dy kontrata për sinjalizimin vertikal dhe horizontal të rrugëve. Realizimin e projektit horizontal e ka kryer kompania "Sinjali", me vlerë të kontratës 45.650.00€.

Në kuadër të këtij projekti janë sinjalizuar rrugët me shenjat horizontale, si vija ndarëse të rrugëve, vendkalime për këmbësorë, ku krahas kësaj është kryer edhe shenjëzimi i parkingjeve në Zonën "Qendër" të qytetit. Sinjalizimi i vendparkingjeve me shenja përkatëse të komunikacionit rrugorë dhe inventarizimi i tyre, është kryer në 35 lokacione të kësaj zone.



Sinjalizimi i rrugëve me shenja horizontale dhe vertikale të komunikacionit rrugorë. Vlera e kontratës 22,480 € nga RSM dhe kompania "Sinjali", 45,200€. Projekti i sinjalizimit ka për qëllim rregullimin e qarkullimit dhe rritjen e sigurisë në komunikacion rrugorë për gjithë pjesëmarrësit në komunikacion rrugorë.

Menaxhimi i parkingjeve

Për menaxhimin e hapësirave të parkimit të tipit të mbyllur, ku ka një hyrje dhe dalje, janë realizuar projektet për vendosjen e laurave me sistem modern të menaxhimit.

Vendosja e laurave për menaxhim të parkingjeve dhe qarkullimin e komunikacionit në hyrje të parkut "Gërmia". Kjo mundëson monitorimin e plotë të lëvizjeve në hyrje dhe dalje të parkut, pasi që këtu hyrja është me pagesë.



Projekte të tilla janë duke u realizuar edhe në dy lokacione ku do të bëhet menaxhimi i hapësirave të parkimit njëra prapa "Pallatit të Rinisë", kurse tjetra afër shkollës së Mesme të Mjekësisë.

Rregullimi i Tregut të automjeteve në Zonën Industriale dhe Tregut në lagjen "Kodrën e Trimave", me zhavorr

Rregullimi i tregut për shitjen e veturave, rregullimi me zhavorr, në Zonën industriale dhe në lagjen "Kodra e Trimave", me vlerë të kontratës 28,711 €, të cilën e ka realizuar kompania "Lindi Com". Projekti ka për qëllim rregullimin e hapësirave ku menaxhohen nga Komuna e Prishtinës, si tregjet dhe rrugët rurale.

Bazuar në këtë, është krijuar hapësirë e mjaftueshme për zhvillimin e tregut të automjeteve në Zonën Industriale, si dhe në lagjen "Kodra e Trimave" është përgatitur tereni për tregun e kombinuar.

Rregullimi i pusetave dhe pastrimi i lumenjve

Projekti është në realizim, me vlerë të kontratës 80,524.60€, e kontraktuar nga kompania "Lindi". Në kuadër të këtij projekti është pastruar përroi, i cili gjendet në fshatin "Prugovc", "Bërnice", për parandalimin e vërshimeve, ngase këtu kemi pasur probleme të vazhdueshme gjatë reshjeve të shiut.

RRETHIMI I VARREZAVE

Me kontratën 616 16 022 521, me operatorin ekonomik NNP "Edi Kon", me vlerë prej 55.241,12 €, është realizuar projekti "Rregullimi dhe rrethimi i varrezave të qytetit"

Në këto lokacione :

Marec, janë rregulluar varrezat e dëshmorëve ;
Mramor dhe Ballaban, janë rregulluar varrezat e dy fshatrave;
Siqevë, janë rregulluar varrezat e martirëve.